


# Roli i Kuvendit në procesin e monitorimit të zbatimit të ligjeve



# **Roli i Kuvendit në procesin e monitorimit të zbatimit të ligjeve**

---

## **Përbajtja:**

Personeli.....	3
Hyrje.....	4
Sundimi i ligjit nga këndvështrimi i Raporteve ndërkombëtare .....	5
Roli i Komisioneve parlamentare në fushën e monitorimit të zbatimit të ligjeve .....	7
Kapacitetet profesionale dhe materiale të komisioneve parlamentare në procesin e monitorimit të zbatimit të ligjeve.....	9
Ligjet që iu nënshtuan monitorimit në pesë vitet e fundit .....	11
Konkluzione.....	15

## **Personeli**

Ismet KRYEZIU –  
Drejtor Ekzekutiv  
email: ikryeziu@kdi-kosova.org

Valmir ISMAILI –  
Kordinator i Programeve  
email: vismili@kdi-kosova.org

Vjollca VOGËL - Menaxhere e  
administratës dhe financave  
email: vjollca@kdi-kosova.org

Leonora CIKAJ - Asistente për  
administratë dhe financa  
email: lcikaj@kdi-kosova.org

Arsim Gjinovci - IT &Design  
email: agjinovci@kdi-kosova.org

### **PROGRAMI: DEMOKRATIZIMI DHE PRAKTIKAT PARLAMENTARE**

Driton SELMANAJ –  
Menaxher i programit  
email: dselmanaj@kdi-kosova.org

Isuf ZEJNA - Analyst  
email: izejna@kdi-kosova.org

### **PROGRAMI: QEVERISJA LOKALE DHE PJESEMARRJA QYTETARE**

Naim CAHANAJ - Koordinator  
email: ncahanaj@kdi-kosova.org

### **PROGRAMI: TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI**

Merita MUSTAFA –  
Menagjere e programit  
email: mmustafa@kdi-kosova.org

Besnik RAMADANAJ -  
Kordinator i projektit  
email: bramadanaj@kdi-  
kosova.org

Enis XHEMAILI –  
Hulumtues/Analist  
email: exhemaili@kdi-kosova.org

Shqipe GJOCAJ –  
Hulumtuese/ Analiste  
email: shgjocaj@kdi-kosova.org

Besian BICURRI-  
Hulumtues/Analist  
email: ebicurri @kdi-kosova.org

Nora JUSUFI –  
Asistent i Hulumtimit  
email: njusufi@kdi-kosova.org

## Hyrje

Sistemi juridik në Kosovë për një periudhë relativisht të gjatë, u përballe me një dualizëm kompetencash në fushën e ligjërjes. Korniza Kushtetuese e cila ishte në fuqi deri në muajin prill 2008, përpos Kuvendit të Kosovës, si autoritet me kompetenca në draftimin e legjislacionit njihte edhe PSSP-në (Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm). Për ta bërë edhe më të komplikuar këtë segment, ishte lënia në zbatim edhe e ligjeve që kishin qene në fuqi deri në suprimimin e autonomisë dhe atyre pas kësaj periudhe, por që nuk kanë qenë diskriminuese. Kjo bëri që Kosova de facto dhe de jure të ishte një shembull i paprecendent me tri rende juridike në të njëjtën kohë.

Megjithatë me kalimin e kohës e me theks të veçantë pas shpalljes së pavarësisë, dhe pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kjo çështje duket se po i takon së kaluarës. Institucionet e vendit, po bëjnë përpjekje për etablimin e një rendi unik ligjor në tërë territorin e Kosovës, duke e koncentruar gjithë procesin e ligjvënisë në institucionin e vetëm që është bartës i pushtetit legjislativ në vend- Kuvendin e Kosovës.

Kuvendi i Kosovës, deri më tani ka aprovuar në të dy leximet 497 projektligje. Një numër i konsiderueshëm i tyre, janë miratuar si ligje të cilat për herë të parë kanë normuar rregulla të caktuara shoqërore, kurse pjesa tjeter ka zëvendësuar rregulloret dhe aktet tjera administrative të miratuara nga Administrata e UNMIK-ut, në Kosovë. Megjithatë përkundër që struktura legjislative në Kosovë, gjithnjë e më tepër po kompletohet, sfidë jashtëzakonisht e madhe po paraqitet implementimi në praktikë i këtij legjislacionit të aprovuar.

Institucionet ekzekutive në nivel qendrore dhe atë lokal, akoma nuk po dëshmojnë gatishmëri të plotë, për të implementuar të gjitha dispozitat ligjore, që dalin nga legjislacioni i aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kjo shpeshherë po vjen si rezultat i mungesës

së vullnetit dhe përkushtimit të bartësve të institucioneve të caktuara për t'i implementuar, por jo rrallë herë edhe nga mungesa e kapaciteteve profesionale për interpretim dhe zbatim të çdo dispozite ligjore.

Në mungesë të një strategje gjithëpërfshirëse për sundimin e ligjit, por dhe vullnetit politik, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës, në vazhdimësi po dëshmojnë se e kanë injoruar procesin e zbatimit në praktikë të ligjeve të miratuara. Ideja e nxjerrjes së një numri sa më të madh ligjeve pa u preokupuar mbi fazat e implementimit të tyre, gjithnjë e më tepër po kuptohet si një qasje e gabuar dhe që sjell probleme shumë të mëdha në fuqizimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Ky punim do të tentojë të identifikojë problemet me të cilat po përballet Kuvendi i Kosovës me trupat e saj vartëse, në ushtrimin e kompetencave të tyre në fushën e monitorimit të zbatimit të ligjeve. Po ashtu do të tentojë të ofrojë përgjigje për atë se cilat janë kapacetetet aktuale, profesionale dhe materiale të komisioneve parlamentare për realizimin e këtyre kompetencave, si dhe sa kanë qenë efikas këto komisione në monitorimin e zbatimit të ligjeve.

## **Sundimi i ligjit nga këndvështrimi i Raporteve ndërkombëtare**

Një numër i madh i Raporteve ndërkombëtare që pasqyrojnë proceset nëpër të cilat po kalon Kosova, me theks të veçantë Raportet periodike të Komisionit Evropian, në vazhdimësi kanë konstatuar mungesën e fuqizimit të sundimit të ligjit, si një ndër problemet qenësore në Kosovë. Sipas vlerësimeve të këtyre raporteve, mungesa e fuqizimit të sundimit të ligjit është sfidë jo vetëm për Kuvendin e Kosovës po për të gjitha institucionet

kompetente: Qeverinë, institucionet lokale, dhe të gjitha organet tjera ekzekutive.

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2008, kishte konstatuar se “Kuvendi ka mungesë të theksuar të ekspertizës për të pasur shqyrtim efektiv dhe ka mungesë të kapacitetit për të siguruar mbikëqyrje efektive të implementimit të ligjeve”<sup>1</sup>. E njëjta gjë pothuajse u përsërit edhe në raportet për vitet 2009 dhe 2010 dhe 2011<sup>2</sup>, por tanimë duke konstatuar sfidat e implementimit të ligjeve në shumë nga sektorët qendrorë të shtetit si në: administratën e shtetit, në luftën kundër korruptionit e deri tek mos zbatimi i legjislacionit që prekin liritë dhe të drejtat e njeriut.

Raporti i fundit i këtij institucioni për vitin 2012, edhe pse ndërroi për nga emri dhe struktura, megjithatë ai nuk ndryshoi edhe në përbajtjen e tij. Raporti tanimë i titulluar Studimi i Fizibilitetit për Kosovën, ishte edhe më i qartë në adresimin e kësaj problematike, duke reflektuar për shumë dikastere që Kuvendi i Kosovës do të duhej të ushtronte rolin dhe mandatin e tij kushtetues. Në njëren nga paragrafët e këtij raporti shkruhet se, në veçanti Kuvendi duhet të fuqizoj mbikëqyrjen e tij mbi ekzekutivin dhe sektorin e sigurisë përmes rishikimit të legjislacionit dhe monitorimit të zbatimit të politikave dhe ligjeve<sup>3</sup>.

Gjendja e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit nuk është pasqyruar më mirë as në raportin e Grupit Ndërkombëtar të Krizave, të publikuar në maj të vitit 2010. Duke adresuar vlerësimë për sektorë në veçanti, aty thuhet se: Agjencitë e zbatimit të ligjit (policia, prokurorët dh gjykatat) janë të çoroditura dhe ndikohen nga politika,

---

<sup>1</sup> Raporti i Progresit 2008 - <http://www.scribd.com/doc/16541221/raporti-i-progresit-2008>

<sup>2</sup> Raporti i Progresit për Kosovën 2011

\*[http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/20111018\\_progress\\_report\\_sq.pdf](http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_sq.pdf)

<sup>3</sup> Studimi i Fizibilitetit për Kosovën 2012

[http://www.meiks.net/repository/docs/Komunikate\\_nga\\_Komisioni\\_per\\_Parlementin\\_Evropian\\_dhe\\_Keshillin.pdf](http://www.meiks.net/repository/docs/Komunikate_nga_Komisioni_per_Parlementin_Evropian_dhe_Keshillin.pdf).

krimi i organizuar dhe korrupsioni<sup>4</sup>. Pothuajse konstatime dhe rekomandime të ngjashme janë prezantuar edhe në raportet periodike të organizatave tjera ndërkombëtare si Human Rights Watch, Freedom House, Transparency international etj.

## **Roli i Komisioneve parlamentare në fushën e monitorimit të zbatimit të ligjeve**

Komisionet parlamentare janë trupat kryesor që funksionalizojnë punën e Kuvendit të Kosovës. Roli i komisioneve përveç në krijimin e sistemit juridik manifestohet edhe në mbikëqyrjen e funksionimit të rendit juridik, duke ushtruar mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Në këtë drejtim secili komision nga fushëveprimi i tij ka autoritet të ushtroj mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nga ministria përkatëse<sup>5</sup>. Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës, me nenin 73 të saj, ka përcaktuar autoritetin e komisioneve parlamentare për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Kjo Rregullore u jep të drejtë dhe detyrim secilit komision parlamentar, që të kontrolloj dhe studioj efektivitetin e ligjeve në fuqi në kuadër të fushëveprimit të tyre, zbatimin e tyre dhe propozojnë masa për rastet konkrete.<sup>6</sup>

Mandati i komisioneve të përhershme dhe komisioneve funksionale ndërlidhet me mandatin e legislaturës. Secilit komision i përcaktohet fushëveprimtaria e tij dhe në kuadër të fushëveprimit përcaktohet

---

<sup>4</sup> International Crisis Group (ICG) - The rule of law in independent Kosova / may 2010, <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/204-the-rule-of-law-in-independent-kosovo.aspx>

<sup>5</sup> Intervistë personale me Arben Gashin – Kryetar i Komisionit parlamentar për Legjislacion dhe Gjyqësi

<sup>6</sup> Rregullorja e Kuvendit të Kosovës, Neni 73, paragrafi 2 dhe 3.

[http://kuvendikosoves.org/common/docs/Rr\\_K\\_RK\\_29\\_04\\_2010\\_shqip.pdf](http://kuvendikosoves.org/common/docs/Rr_K_RK_29_04_2010_shqip.pdf)

dhe ushtrimi i mbikëqyrjes së zbatimit ligjeve. Kjo çështje është e përcaktuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>7</sup>.

Për ta ushtruar autoritetin dhe kompetencën e tillë, komisionet parlamentare ndërmarrin veprime dhe aktivitete, me qëllim të mbikëqyrjes së veprimtarisë së përgjithshme të ministrive përkatëse. Komisionet, për detyra specifike, me anëtarët e vet mund të formojnë nën-komisione apo grupe punuese, duke i ngarkuar që të kryejnë aktivitete që janë në kompetencë të komisionit në bazë të autorizimeve që i jep ai. Ato për punën e vet i raportojnë komisionit që i ka themeluar, i cili më pas vendos për procedimin e mëtutjeshëm për miratim në mbledhjet plenare të Kuvendit.

Rregullorja e punës së Kuvendit, gjithashtu ka përcaktuar edhe obligimin, që kabineti qeveritar përmes ministrive përkatëse së paku një herë në vit, madje edhe pa kërkesë të komisioneve parlamentare, ti raportojë komisionit funksional në lidhje me zbatimin e ligjeve që bien nën kompetencën e ministrive të caktuara.

Në çdo fillim vit, komisionet parlamentare përfshinë në planifikimet e tyre të punës edhe monitorimin e zbatimit të ndonjë ligji që del nga fushë-veprimtaria e tyre. Pavarësisht planifikimeve dhe përkundër që kjo e drejtë dhe detyrë i garantonhet komisioneve parlamentare, ato si të tilla po vazhdojnë ta neglizhojnë duke mbikëqyrur një numër tejet simbolik apo duke mos mbikëqyrur fare asnjë ligj që del nga kompetencat dhe fushë-veprimtaria e secilit komision në veçanti.

---

<sup>7</sup> Intervistë personale me Arben Gashin – Kryetar i Komisionit parlamentar për Legjislacion dhe Gjyqësi

## Kapacitetet profesionale dhe materiale të komisioneve parlamentare në procesin e monitorimit të zbatimit të ligjeve

Përkundër numrit shumë të vogël të ligjeve që ju kanë nënshtuar procesit të vlerësimit nga ana e komisioneve parlamentare për zbatueshmërinë e tyre në praktikë, sfidë tjetër mbetet kapacitetet e pamjaftueshme profesionale dhe materiale që kanë në dispozicion komisionet parlamentare në ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Me vendimin e Kryesisë së Kuvendit në fillim të secilit vit kalendarik, komisioneve parlamentare ju alokohet shuma prej 5 mijë eurove për realizimin e planifikimeve vjetore, kurse komisioneve të përhershme ju alokohen 10 mijë euro. Kjo shumë iu dedikohet komisioneve parlamentare për të gjitha aktivitetet e planifikuar brenda një viti kalendarik. Gjithashtu duke u nisur nga fakti se përbërja e komisioneve reflekton, përbërjen politike të Kuvendit të Kosovës, dhe fatkeqësisht subjektet politike parlamentare në shumicën e rasteve nuk i delegojnë në komisione deputetët sipas përgatitjes së tyre profesionale, atëherë nxjerrë konkludimin se komisionet parlamentare e kanë të vështirë monitorimin objektiv dhe profesional të zbatimit të ligjeve në praktikë. Një konstatim të tillë e konfirmon edhe deputeti Armend Zemaj – kryetar i Nën-komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore te Punës, i cili thotë se puna dhe kapacitetet e komisioneve parlamentare në procesin e monitorimit të ligjeve varet shumë nga përfaqësimi profesional i subjektit politik si dhe angazhimi dhe vullneti politik për çështje të caktuara<sup>8</sup>.

Të vështirë këtë proces e bën edhe angazhimi shumë i vogël i ekspertëve jashtë institucionit të Kuvendit. Duke u nisur nga fakti se ky institucion nuk e ka shumë të pasur listën e ekspertëve, atëherë e

---

<sup>8</sup> Intervistë personale me Armend Zemaj – Kryetar i Nën-komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore te Punës

gjitha ndihma varet tek ekspertiza të cilën e ofrojnë organizatat që e ndihmojnë punën e Kuvendit si: NDI, OSBE, GIZ, UNICEF, UNDP etj.

Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për angazhimin e ekspertëve në ofrimin e ekspertizës së nevojshme varësisht nga fusha që rregullojnë ligje të caktuara, është po ashtu problem tjetër që dëshmon draftimin e raporteve krejtësisht sipërfaqësore nga ana e komisioneve parlamentare. Kjo qasje e Kuvendit duhet të ndryshojë dhe komisioneve parlamentare, duhet ofruar mbështetje e mjaftueshme materiale me qëllim të angazhimit të resurseve që kanë ekspertizë në vlerësimin objektiv të nivelit t zbatimit të një ligji të caktuar. Po ashtu grupet parlamentare duhet të reflektojnë në delegimin e deputetëve në komisionet parlamentare sipas përgatitjes së tyre profesionale dhe jo vetëm sipas kritereve politike.

Megjithatë mendim tjetër ka Arben Gashi – kryetar i komisionit parlamentar për legjislacion dhe Gjyqësi, i cili mendon se komisionet parlamentare kanë kapacitete profesionale edhe materiale për të ushtruar mbikëqyrjen e ligjeve. Mirëpo fillimisht me planin e punës përcaktohen prioritete vjetore, dhe sipas tij edhe më tutje energjia e Kuvendit është e koncentruar në nxjerrjen e ligjeve dhe përbushjen e obligimeve tjera që dalin nga raporti progresit dhe fushëveprimi i tij. Kjo qasje e Kuvendit duke u marrë në masë të madhe me miratimin e ligjeve, pothuajse i ka vënë nën hije aktivitetet dhe kompetencat tjera të Komisioneve parlamentare<sup>9</sup>.

Sfidë tjetër e këtij procesi që nuk ka të bëjë me mungesën e kapaciteteve profesionale dhe materiale të komisioneve parlamentare, është mungesa e gatishmërisë së Kuvendit që të përcjellë implementimin e rekomandimeve të dala nga procesi i monitorimit të zbatimit të ligjeve, si dhe mospërfillja e rekomandimeve nga ana e Qeverisë së Kosovës, përkundër që disa

---

<sup>9</sup> Intervistë personale me Arben Gashin- Kryetar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

raste komisionet ofrojnë një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve për zbatimin e ligjeve<sup>10</sup>.

## **Ligjet që iu nënshtuan monitorimit në pesë vitet e fundit**

Procesi i monitorimit të zbatimit të ligjeve, ka filluar me iniciativën e Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), qysh në vitin 2006 ku është hartuar edhe një dokument në formë të një manuali të shkurtër i cili sinqrononte se si duhet të bëhet monitorimi i zbatimit të ligjeve nga ana e komisioneve parlamentare. Ligjin e parë të cilin e ka monitoruar Kuvendi i Kosovës, përkatësisht Komisioni i atëherdhëm për shëndetësi, ishte Ligji për Shëndetësi. Ky proces ka pasur impakt të madh, po ashtu edhe mbulueshmëri shumë të madhe mediale. Kjo përfaktin se për herë të parë Kuvendi fillonte të kontrolloj qeverinë në fushën e zbatimit të ligjeve, madje kjo e përcjellur edhe me tituj shumë bombastik nga të gazetat e përditshmet në Kosovë<sup>11</sup>.

Ndërkohë që në vitin 2007, po kjo organizatë, ka filluar projektin përmes mbështetjen me staf, të komisioneve parlamentare, ku qëllimi kryesor ka qenë që komisionet të fillojnë të hartojnë planet e tyre të punës në të cilat do të përfshihej edhe monitorimi i zbatimit të së paku 2 ligjeve brenda një viti. Që nga viti 2008 të gjitha komisionet kanë filluar këtë praktikë të hartimit të planeve vjetore, edhe pse jo të gjitha nga to i realizojnë planet sipas parashikimeve të tyre në se cilin fillim vit<sup>12</sup>.

Përkundër kësaj iniciative, të dhënët zyrtare që dalin nga aktivitetet e Kuvendit që nga viti 2008, në fushën e monitorimit të zbatimit të ligjeve nga ana e komisioneve parlamentare, nuk janë fare

---

<sup>10</sup> Intervistë me Suzana Novobërdaliu- Kryetare e Komsionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pajqetur dhe Peticione

<sup>11</sup> Intervistë personale – Arben Kelmendi NDI

<sup>12</sup> Intervistë personale – Arben Kelmendi NDI

inkurajuese. Në total numri i ligjeve të monitoruara gjatë periudhës pesë vjeçare nuk kalon shifrën e 36 ligjeve të monitoruara. Marrë parasysh numrin prej 497 projektligjeve të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, që nga konstituimi i legjislaturës së parë, dhe duke u nisur nga fakti i numrit mjaft të madh të komisioneve parlamentare (13) që funksionojnë në kuadër të Kuvendit, del se komisionet parlamentare, funksionin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve e kanë kryer në mënyrë tejet simbolike, ku nga numri total i ligjeve, nuk është arritur as shifrën e 10% e ligjeve të monitoruara.

Gjatë kësaj periudhe është evidentuar se ka dallime të mëdha nga viti në vit, në ushtrimin e kësaj veprimtarie nga ana e komisioneve parlamentare. Përderisa gjatë vitit 2008 dhe 2009 janë monitoruar vetëm nga shtatë ligje, në vitin 2010 kemi një rënie drastike në vetëm në tri ligje të monitoruara. Paksa më inkurajues ishte viti 2011 me gjithsejtë 11 ligje të monitoruar, duke u kthyer në vitin 2012, përsëri në numrin e shtatë ligjeve të monitoruara.

Tabela në vijim paraqet listën e ligjeve të cilat janë monitoruar nga ana e komisioneve parlamentare gjatë periudhës 2008 -2012.

<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>
Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve penale	Ligji penal për të mitur	Ligji për faljen	Ligji për duhanin	Ligji për Inspektoratin e Punës
Ligji për mbrojtjen e konsumatorit	Ligjet për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërtë	Ligji për departamentin e mjekësisë ligjore	Ligji për Minierat dhe Minerale	Ligji për shpronësimin e pronës se paluajtshme
Ligji për Qasjen në Dokumentet Zyrtare	Ligji nr. 2003/11 përrugët	Ligji për telekomunikacionin	Ligji për financat e pushtetit lokal	Ligji për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës
Ligji për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë	Ligji për Vetëqeverisjen Lokale		Ligji për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së	Ligji për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit
Ligji për Veprimtarinë Private në Shëndetësi	Ligji për Kadastrin		Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të RKS	Ligji i Punës
Ligji për Auditimin e Brendshëm	Ligji për Inspektoratin e Punës		Ligji për qasje në dokumente publike	Ligji për eficiencën e energjisë
Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në RKS	Ligji për Mbeturina		Ligjet për mbrojtjen nga dhuna në familje	Ligji për mbrojtjen e konkurrencës
			Ligji për Ripranim	
			Ligji për tokën bujqësore	
			Ligji për liritë fetare në Kosovë	
			Ligji për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar	

*Tab. 1 Numri dhe emri i ligjeve të monitoruara.*

Në grafikonin e mëposhtëm janë paraqitur në shifra dhe përqindje numri i ligjeve të miratuara nga ana e Kuvendit të Kosovës, që nga konstituimi i legislaturës së parë në vitin 2001, si dhe numri i ligjeve që janë monitoruar nga komisionet parlamentare nga viti 2008-2012.

## Numri i ligjeve të miratuara dhe numri i ligjeve të monitoruara

- Nr. i Ligje të miratuara në katër legislurat 497
- Nr. I Ligjeve të monitoruara 36




Figura .2. Paraqitura në përqindje e numrit të ligjeve të miratuara dhe të monitoruara

## **Konkluzione**

- Kuvendi i Kosovës përmes trupave të tij, duhet të dëshmojë vullnet dhe gatishmëri në monitorimin e zbatimit te ligjeve dhe thirrjes në përgjegjësi për institucionet që kanë kompetencë për t'i implementuar ligjet.
- Duhet të rritet mbështetja materiale dhe profesionale për komisionet parlamentare në fushën e monitorimit të zbatimit të ligjeve.
- Komisionet parlamentare, procesin e monitorimit të zbatimit të ligjeve duhet ta ushtrojnë në mënyrë më gjithëpërfshirëse, duke u angazhuar edhe në terren për të parë nga afër sfidat objektive, që ligjet e caktuara hasin gjatë implementimit në praktikë.
- Qeveria e Kosovës duhet të zbatojë të gjitha rekomandimet që dalin nga procesi i monitorimit të zbatimit të ligjeve, nga ana e Kuvendit të Kosovës.
- Institucionet ekzekutive duhet ndërmarrin të gjitha masat në implementimin e të gjitha dispozitave ligjore që dalin nga legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë.
- Institucionet lokale ekzekutive duhet të ngrisin kapacitetet profesionale brenda shërbimit civil, për zbatimin e ligjeve që bie në kompetencën e tyre.

“Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti “ Informimi i qytetarëve për punën e Kuvendit të Kosovës dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes”, i financuar nga The Balkan Trust for Democracy BTD. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit Demokratik të Kosovës KDI, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i BTD-së.